



**Kuvendi i Komunës Klinë**

01Nr. 06-8435 /2025

Datë: 26.03 /2025

*Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronjën d) dhe nenit 40. paragrafi 40.2 shkronjën c) dhe l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040. Nenit 10 pikën 4) dhe Nenin 40 pikën 11 të Statutit të Komunës së Klinës i miratuar në Mars 2010. Dispozitat e Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, dispozitat e Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna si dhe me rekomandimet e KPF-së, pas debateve të zhvilluara me publikun, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt për vitin 2025 të mbajtur me datë: 21.03.2025, mori këtë:*

**V E N D I M**

***Për Miratimin e Planit të Veprimit për Transparenc 2025-2029***

1. Miratohet Plani i Veprimit për Transparenc 2025-2029 në Komunën e Klinës.
2. Plani i Veprimit për Transparencë synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale llogaridhënëse dhe transparente, të hapur për qytetarë dhe shoqërinë civile në të gjitha proceset vendimmarrëse.
3. Pjesë përbërse e këtij vendimi është Plani i Veprimit për Transparenc 2025-2029.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet kryetari i komunës në bashkëpunim me drejtorin për Administratë dhe drejtorit të tjera komunale.
5. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:**

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Administratë;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



**Kryesues i Kuvendit  
Fadil Gashi**